



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Glogocit



# PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS

2025 – 2029



Tetor 2025

**Përmbajtja:**

|                                                                             |           |
|-----------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 1. HYRJE .....                                                              | 8         |
| 2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE .....                                 | 12        |
| 2.1 Ligjet dhe rregulloret kombëtare .....                                  | 12        |
| 2.2 Politikat dhe dokumentet strategjike të nivelit lokal dhe qendror ..... | 12        |
| 2.3 Roli i institucioneve dhe strukturat organizative .....                 | 13        |
| 2.4 Përdorimi i të dhënave statistikore.....                                | 13        |
| 3. PËRSHKRIMI I KOMUNËS SË DRENASIT.....                                    | 14        |
| 3.1 Karakteristikat gjeografike dhe klimatike.....                          | 17        |
| 3.2 Ekonomia lokale .....                                                   | 19        |
| 3.3 Demografia dhe zhvillimi urban .....                                    | 21        |
| 3.4 Përdorimi i tokës .....                                                 | 23        |
| 3.5 Burimet natyrore .....                                                  | 26        |
| 3.6 Infrastrukturë dhe shërbime .....                                       | 31        |
| 4. GJENDJA E MJEDISIT .....                                                 | 36        |
| 4.1 Ajri .....                                                              | 38        |
| 4.1.1 Burimet e ndotjes së ajrit .....                                      | 38        |
| 4.1.2 Të dhëna statistikore .....                                           | 41        |
| 4.2 Ujërat.....                                                             | 41        |
| 4.2.1 Burimet e ujit .....                                                  | 41        |
| 4.2.2 Ndotja e ujërave .....                                                | 42        |
| 4.3 Toka dhe përdorimi i tokës .....                                        | 44        |
| 4.4 Biodiversiteti dhe pyjet.....                                           | 48        |
| 4.5 Menaxhimi i mbeturinave .....                                           | 48        |
| 4.6 Zhurma dhe ndotjet e tjera .....                                        | 48        |
| 4.7 Ndryshimet klimatike dhe sfidat e ardhshme.....                         | 48        |
| 5. ANALIZA DPSIR DHE IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE KRYESORE .....               | 49        |
| 5.1 Faktorët ndikues në mjedis .....                                        | 49        |
| 5.2 Faktorët ndikues.....                                                   | 49        |
| <b>5.3 Gjendja.....</b>                                                     | <b>50</b> |
| 5.4 Ndikimet .....                                                          | 50        |

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2025 – 2029

|                                                                          |    |
|--------------------------------------------------------------------------|----|
| 5.5 Reagimi .....                                                        | 50 |
| 5.6 Identifikimi i problemeve kryesore.....                              | 50 |
| 6.OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET STRATEGJIKE .....                           | 52 |
| 6.1 Objektivat kryesore .....                                            | 52 |
| 6.2 Prioritetet strategjike .....                                        | 53 |
| 6.3 Lidhja me Planin Kombëtar të Veprimit në Mjedis.....                 | 53 |
| 7. PLANI I VEPRIMIT.....                                                 | 54 |
| 7.1 Struktura e planit të veprimit .....                                 | 54 |
| 8. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT .....                             | 57 |
| 8.1 Qëllimi i monitorimit .....                                          | 57 |
| 8.2 Mekanizmat e monitorimit.....                                        | 57 |
| 8.3 Raportimi i progresit .....                                          | 58 |
| 8.4 Roli i komisionit dhe ekspertit.....                                 | 58 |
| 8.5 Vlerësimi i efektivitetit .....                                      | 59 |
| 9. FINANCIMI DHE BURIMET E NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E PLVM.....            | 60 |
| 9.1 Burimet financiare .....                                             | 60 |
| 9.2 Vlerësimi i kostove .....                                            | 61 |
| 9.3 Menaxhimi i burimeve.....                                            | 62 |
| 9.4 Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare .....                          | 62 |
| 10. PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT DHE NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT ..... | 63 |
| 10.1 Identifikimi i palëve të interesit .....                            | 63 |
| 10.2 Strategjitë e përfshirjes .....                                     | 64 |
| 10.3 Përgjegjësitë e palëve të interesit.....                            | 65 |
| 10.4 Mekanizmat e ndërgjegjësimit.....                                   | 65 |
| 11. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....                                     | 66 |
| 11.1 Përfundimet kryesore .....                                          | 66 |
| 11.2 Rekomandime për implementim.....                                    | 67 |
| SHTOJCAT DHE REFERENCAT.....                                             | 69 |
| Shtojca 1: Tabela e treguesve mjedisorë për Komunën e Drenasit .....     | 69 |
| Shtojca 2:Përmbledhja e gjendjes mjedisore .....                         | 70 |
| Shtojca 3: Plani i veprimit.....                                         | 70 |
| Shtojca 4: Burime ligjore dhe strategjike.....                           | 71 |

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2025 – 2029

|                                                                                         |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Shtojca 5: Referencat statistikore dhe të dhënat .....                                  | 71        |
| Lista e hartave .....                                                                   | 71        |
| Lista e figurave .....                                                                  | 72        |
| Lista e shkurtesave .....                                                               | 72        |
| <b>1. Dokumentet Ligjore dhe Strategjike (Shtojca 4 dhe Teksti) .....</b>               | <b>73</b> |
| <b>2. Burimet Statistikore dhe Raportet Institucionale (Shtojca 5 dhe Teksti) .....</b> | <b>74</b> |

**FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS**

Të nderuar qytetarë të Komunës së Drenasit, të nderuar lexues!

Sot Komuna e Gllogocit (Drenasit) prezanton Planin Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), një dokument planifikues e strategjik, që synon adresimin dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal.

Duke u mbështetur në gjendjen aktuale mjedisore, në këtë plan janë përcaktuar prioritetet mjedisore për periudhën pesëvjeçare (2025–2029).

Thelbi i këtij plani është të identifikojë dhe të ofrojë zgjidhje për problemet prioritare mjedisore në territorin e Komunës së Gllogocit (Drenasit), duke synuar një menaxhim sa më efektiv të tyre. Po ashtu, PLVM-ja synon vendosjen e çështjeve mjedisore në agjendën e institucioneve përgjegjëse dhe përfshirjen e opinionit publik në mënyrë të vazhdueshme.

Objektivat kryesore të planit përfshijnë: vlerësimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve nga sektorët zhvillimorë; identifikimin dhe përcaktimin e problemeve kryesore mjedisore në territorin e komunës; caktimin e prioriteteve që do të adresohen gjatë periudhës pesëvjeçare; si dhe planifikimin e afateve, aktiviteteve dhe projekteve që do të ndërmerren për zbatimin e tyre.

Vizioni i PLVM-së është një qytet i Drenasit me mjedis të pastër, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me theks në bujqësi, si dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe turizmit lokal. Ky vizion është në përputhje të plotë me dokumentet strategjike të Komunës së Drenasit, veçanërisht me Planin Zhvillimor Komunal 2020–2027+.

Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë parasysh edhe kërkesat e Strategjisë së Kosovës për Mjedisin 2013–2022, të zhvilluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Kjo strategji përbën bazën e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis, duke ofruar orientimet strategjike dhe kornizën kombëtare të veprimeve për mbrojtjen e mjedisit.

Prioritetet mjedisore të Komunës së Gllogocit (Drenasit) përfshijnë: menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore; sigurimin e ujit të pijes me cilësi të lartë; mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet; ruajtjen e pyjeve nga prerjet pa kriter dhe djegiet; forcimin e bazës ligjore dhe institucionale për menaxhimin e ndotjes së ajrit; reduktimin e zhurmës; mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara dhe erozioni; rikultivimin e tokave të degraduara; si dhe përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave.

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2025 – 2029

Një rëndësi e veçantë i kushtohet eliminimit të deponive ilegale, nxitjes së ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave, rritjes së numrit të zonave të mbrojtura dhe promovimit të vlerave të tyre natyrore.

Po ashtu, parandalimi i veprimeve që dëmtojnë natyrën dhe biodiversitetin është pjesë thelbësore e këtij plani, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe llojeve të rralla bimore e shtazore.

Duke hartuar politika efikase për mbrojtjen e natyrës dhe duke zgjeruar sipërfaqet e zonave të mbrojtura, ne përmbushim obligimin që gjeneratave të ardhshme t'u japim mundësinë të shijojnë vlerat e rralla natyrore të Komunës së Gllogocit (Drenasit).

Në emër të qytetarëve të Komunës së Gllogocit (Drenasit), shpreh mirënjohjen time për të gjithë kontribuesit në hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2025–2029: komisionin komunal, ekipin këshillues të komunitetit dhe ekipin teknik mbështetës. Ju ftoj që këtë dokument strategjik mjedisor ta konsiderojmë si një vlerë të përbashkët, e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët tanë.

Përzemërsisht,

Kryetari i Komunës së Drenasit

**Ramiz LLADROVCI**

**EKIPI KOMUNAL PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL PËR VEPRIMIN NË MJEDIS (PLVM)**

Për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) 2025–2029 për Komunën e Gllogocit, përbërja e ekipit, është përcaktuar me vendimin Nr. 400/01-45313 të datës 15.10.2025.

**Ekipi komunal ka këtë përbërje:**

1. Petrit Gashi, (koordinator)
2. Shaban Dobra, (anëtar)
3. Besart Bajrami, (anëtar)
4. Shkendije Thaqi, (anëtar)
5. Afrim Prokshi, (anëtar)
6. Liridona Durmishi, (anëtar)
7. Marigona Gllareva, (anëtar)
8. Armend Cakiqi, (anëtar)
9. Arberije Gllareva, (anëtar)

**Sipas këtij vendimi: Ekipi Komunal për Planin Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) ka këto përgjegjësi:**

- Të sigurojë të dhënat nga departamenti përkatës,
- Të marrin pjesë në takimet e rregullta konsultative dhe të japin kontributin e tyre në hartimin e PLVM-së,
- Të informojë vendimmarrësit për procesin e hartimit të PLVM-së
- Të marrë pjesë dhe të kontribuojnë në debatin publik me qytetarë në prezantimin e draftit të PLSCA.

## 1. HYRJE

Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm përbëjnë sfidat kryesore për komunat në Kosovë, përfshirë edhe Komunën e Drenasit, e cila është ndër qendrat industriale më të rëndësishme të vendit. Si një komunë me aktivitet të theksuar ekonomik dhe industrial, Drenasi përballët me ndikime të konsiderueshme mbi burimet natyrore, përfshirë cilësinë e ajrit, ujërave dhe tokës bujqësore. Faktorët që ndikojnë në këtë situatë lidhen kryesisht me urbanizimin e shpejtë, aktivitetet industriale të lidhura me “Feronikelin” dhe ndërmarrje të tjera, si dhe shfrytëzimin intensiv të tokës për bujqësi dhe ndërtim.

Sipas të dhënave zyrtare të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë – 2024 (ASK, botuar në korrik 2025), Komuna e Drenasit ka një popullsi prej 48,079 banorësh, nga të cilët 24,134 janë meshkuj dhe 23,945 janë femra. Prej tyre, 12,315 banorë jetojnë në zonat urbane (rreth 25.6% e popullsisë totale), ndërsa 35,764 jetojnë në zonat rurale (74.4%).

Kjo ndarje tregon një dominim të theksuar të zonave rurale, ku bujqësia mbetet aktiviteti kryesor ekonomik, ndërsa në zonën urbane përqendrohen aktivitetet tregtare, administrative dhe industriale.

Popullsia e Drenasit është homogjene etnikisht, pasi mbi 99.9% e saj janë shqiptarë, ndërsa pjesa tjetër përfshin numër shumë të vogël të deklaruar si boshnjakë (13 persona), turq (3), ashkali (1) dhe kategori “të tjerë” (15).

### **Analiza sipas vendbanimeve**

Sipas të dhënave të regjistrimit, komuna përbëhet nga 33 vendbanime, ndër të cilat Gllogoci (qendra komunale) dhe Komorani janë vendbanime urbane, ndërsa të gjitha të tjerat janë rurale. Disa prej vendbanimeve me numrin më të lartë të popullsisë janë:

- **Gllogoc (qendra komunale)** – 7,081 banorë
- **Komorani** – 3,354 banorë
- **Llapushnik** – 2,904 banorë
- **Nekoc** – 2,498 banorë
- **Arllat** – 2,348 banorë

- **Poklek** – 1,875 banorë
- **Baicë** – 1,965 banorë
- **Dobroshec** – 1,125 banorë
- **Kishnarekë** – 1,194 banorë
- **Korroticë e Epërme dhe e Ulët** – përkatësisht 1,158 dhe 990 banorë.

Këto të dhëna tregojnë shpërndarje të dendur të popullsisë në disa fshatra të mëdha, duke theksuar karakterin pjesërisht të urbanizuar dhe të përqendruar rreth zonave ekonomike. Në kontrast, disa vendbanime si Vuçak (238 banorë) dhe Zabel i Epërm (421 banorë) mbeten me popullsi të ulët, shpesh me tendencë migrimi drejt qendrës komunale.

### **Tendencat demografike dhe zhvillimi**

Në krahasim me regjistrimet paraprake, popullsia e Drenasit ka ruajtur një ritëm të qëndrueshëm, me një strukturë moshore të re dhe një balancë të barabartë gjinore. Megjithatë, urbanizimi dhe migrimi i brendshëm kanë sjellë sfida në aspektin e planifikimit hapësinor, menaxhimit të mbetjeve, dhe ruajtjes së cilësisë së ujit dhe ajrit. Në zonat urbane, densiteti më i madh i popullsisë shoqërohet me rritje të ndotjes ajrore dhe akustike, ndërsa në zonat rurale, praktikat bujqësore tradicionale shpesh ndikojnë në erodimin e tokës dhe ndotjen e burimeve ujore.

Për një zhvillim të qëndrueshëm, Komuna e Drenasit duhet të balancojë aktivitetin industrial me politikën e mbrojtjes së mjedisit, duke forcuar:

- Monitorimin e cilësisë së ajrit dhe ujit;
- Kontrollin e shkarkimeve industriale;
- Promovimin e bujqësisë organike dhe përdorimin e energjive të rinovueshme;
- Planifikimin urban të qëndrueshëm që minimizon ndikimet mjedisore.

(Përmbledhje nga Tabela 2.3 e ASK, Regjistrimi 2024)

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2025 – 2029

**Tabela 1. Tabelë përmbledhëse – Popullsia e Komunës së Glllogovcit sipas vendbanimit (2024)**

| Nr. | Vendbanimi         | Tipi i vendbanimit | Popullsia gjithsej | Meshkuj | Femra |
|-----|--------------------|--------------------|--------------------|---------|-------|
| 1   | Glllogoc (Qendra)  | Urban              | 7,081              | 3,490   | 3,591 |
| 2   | Komoran            | Urban              | 3,354              | 1,672   | 1,682 |
| 3   | Çikatovë e Re      | Urban              | 1,880              | 926     | 954   |
| 4   | Arlat              | Rural              | 2,348              | 1,144   | 1,204 |
| 5   | Llapushnik         | Rural              | 2,904              | 1,430   | 1,474 |
| 6   | Nekoc              | Rural              | 2,498              | 1,235   | 1,263 |
| 7   | Baicë              | Rural              | 1,965              | 1,010   | 955   |
| 8   | Poklek             | Rural              | 1,875              | 930     | 945   |
| 9   | Dobroshec          | Rural              | 1,125              | 575     | 550   |
| 10  | Kishnarekë         | Rural              | 1,194              | 603     | 591   |
| 11  | Korroticë e Epërme | Rural              | 1,158              | 602     | 556   |
| 12  | Korroticë e Ulët   | Rural              | 990                | 516     | 474   |
| 13  | Abri e Epërme      | Rural              | 1,027              | 525     | 502   |
| 14  | Zabel i Ulët       | Rural              | 1,027              | 526     | 501   |
| 15  | Krajkovë           | Rural              | 958                | 493     | 465   |
| 16  | Gllanasellë        | Rural              | 1,086              | 528     | 558   |
| 17  | Polluzhë           | Rural              | 693                | 359     | 334   |
| 18  | Negroc             | Rural              | 960                | 466     | 494   |
| 19  | Sankoc             | Rural              | 1,178              | 617     | 561   |
| 20  | Tërstenik          | Rural              | 3,017              | 1,509   | 1,508 |
| 21  | Tërdec             | Rural              | 678                | 348     | 330   |
| 22  | Vasilevë           | Rural              | 467                | 239     | 228   |
| 23  | Shtrubullovë       | Rural              | 1,193              | 602     | 591   |

## PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2025 – 2029

| Nr.             | Vendbanimi        | Tipi i vendbanimit | Popullsia gjithsej | Meshkuj       | Femra         |
|-----------------|-------------------|--------------------|--------------------|---------------|---------------|
| 24              | Domanek           | Rural              | 517                | 265           | 252           |
| 25              | Vuçak             | Rural              | 238                | 121           | 117           |
| 26              | Vërboc            | Rural              | 783                | 389           | 394           |
| 27              | Zabel i Epërm     | Rural              | 421                | 213           | 208           |
| 28              | Godanc            | Rural              | 210                | 108           | 102           |
| 29              | Gradicë           | Rural              | 327                | 177           | 150           |
| 30              | Fushticë e Epërme | Rural              | 780                | 391           | 389           |
| 31              | Fushticë e Ulët   | Rural              | 738                | 375           | 363           |
| 32              | Çikatovë e Vjetër | Rural              | 1,085              | 549           | 536           |
| 33              | Gllabar           | Rural              | 1,378              | 721           | 657           |
| <b>Gjithsej</b> |                   |                    | <b>48,079</b>      | <b>24,134</b> | <b>23,945</b> |

Plani Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) synon të:

- Identifikojë problemet kryesore mjedisore në territorin e komunës;
- Përcaktohen prioritetet për zgjidhjen e këtyre problemeve;
- Hartojë veprime konkrete dhe projekt-propozime për implementim afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë;
- Promovojë zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

PLVM do të shërbejë si udhëzues për institucionet komunale, komunitetet lokale, sektorin privat dhe shoqërinë civile në drejtim të planifikimit dhe zbatimit të masave mjedisore.

## **2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE**

### **2.1 Ligjet dhe rregulloret kombëtare**

Hartimi i PLVM bazohet kryesisht në Ligjin për Mjedisin në Kosovë (Ligji Nr. 2009/03-L-025), i cili përcakton përgjegjësitë e komunave për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Nenet më të rëndësishme për këtë plan janë:

- Neni 5, pika 3.2 – përcakton se komunat, në bashkëpunim me MMPHI, janë përgjegjëse për përgatitjen e planeve për mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre;
- Neni 5, pika 3.5 – përcakton se Kuvendi Komunal miraton planin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Neni 24 – përcakton se komunat miratojnë planet e veprimit lokal në mjedis ose programe mjedisore, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit në Mjedis (PKVM), duke i përshtatur sipas nevojave dhe interesave specifike të komunës.

Sipas Strategjisë për zhvillim rajonal 2020–2029, synohet të përmirësohet menaxhimi i mbeturinave, monitorimi i cilësisë së ajrit dhe ujërave, si dhe të ruhet biodiversiteti dhe ekosistemet. Kjo strategji shërben si udhërrëfyes për zhvillimin e planeve lokale mjedisore.

### **2.2 Politikat dhe dokumentet strategjike të nivelit lokal dhe qendror**

Përveç ligjit, PLVM duhet të jetë në përputhje me këto dokumente strategjike:

- Plani i Veprimit në Mjedis i Kosovës (PKVM 2022) – përcakton prioritetet kombëtare në mjedis;
- Plani Zhvillimor Komunal i Gllogocit 2020-2028– përcakton vizionin dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm për komunën;
- Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2021–2026 – fokusohet në menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin;
- Raportet e Agjencisë së Mjedisit të Kosovës (2022–2024) – sigurojnë të dhëna mbi cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës;
- Dokumente të tjera sektoriale, si strategjitë për pyjet, biodiversitetin, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, transportin dhe energjinë.

### **2.3 Roli i institucioneve dhe strukturat organizative**

PLVM do të zbatohet nga një rrjet institucional i strukturuar si më poshtë:

- Kuvendi Komunal i Drenasit – miraton planin dhe ndan burimet financiare për implementim;
- Komisioni për PLVM – themeluar nga Kuvendi Komunal, është përgjegjës për koordinimin e hartimit dhe monitorimin e zbatimit;
- Drejtoritë komunale për mjedisin, bujqësinë, urbanizmin, infrastruktura dhe shëndetësinë – mbështesin zbatimin e veprimeve sektoriale;
- MMPHI dhe Agjencia e Mjedisit e Kosovës – ofrojnë udhëzime, mbikëqyrin zbatimin e standardeve dhe ofrojnë mbështetje teknike;
- Shoqëria civile dhe komunitetet lokale – përfshihen në konsultime publike, punëtori dhe monitorim të zbatimit të masave.

### **2.4 Përdorimi i të dhënave statistikore**

PLVM do të bazohet në të dhëna të sakta dhe të verifikuara nga:

- ASK – popullsi, zhvillim ekonomik, përdorimi i tokës, mbeturinat e prodhuara;
- Raportet e Agjencisë së Mjedisit – cilësia e ajrit, ujërave dhe tokës;
- Dokumente dhe raportime komunale – statistikat lokale mbi industri, bujqësi, infrastrukturë dhe projekte mjedisore të mëparshme.

Integrimi i këtyre të dhënave siguron që PLVM të jetë plan i bazuar në evidencë, realistik dhe i zbatueshëm.

### 3. PËRSHKRIMI I KOMUNËS SË DRENASIT

Komuna e Drenasit ndodhet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe shtrihet në një sipërfaqe prej afërsisht 276 kilometra katrorë. Ky territor përbën një nyje të rëndësishme gjeografike dhe ekonomike ndërmjet komunave të Skenderajt, Fushë Kosovës, Lipjanit, Malishevës dhe Klinës, duke e bërë Drenasin një zonë lidhëse të rëndësishme për zhvillimin rajonal.

Relievi i komunës karakterizohet nga kombinimi i fushave pjellore dhe kodrinave të buta, me lartësi që variojnë nga 500 deri në 700 metra mbi nivelin e detit. Kjo përzierje e peizazhit i ka mundësuar komunës zhvillimin paralel të bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve, duke krijuar një bazë të qëndrueshme ekonomike lokale.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024, Drenasi numëron 48,079 banorë rezidentë, prej të cilëve 24,134 janë meshkuj dhe 23,945 janë femra. Pjesa dërmuese e popullsisë, mbi 99.9%, është e përkatësisë shqiptare, duke dëshmuar përbërjen homogjene etnike të komunës. Në aspektin e shpërndarjes hapësinore, 12,315 banorë (rreth 26%) jetojnë në zona urbane – kryesisht në qytetin e Drenasit dhe qendrat dytësore si Komorani dhe Çikatova e Re – ndërsa rreth 74% e popullsisë është e përqendruar në zonat rurale, ku bujqësia, mbarështimi i kafshëve dhe pylltaria mbeten burimet kryesore të të ardhurave.

Në krahasim me regjistrimin paraprak, Komuna e Drenasit ka shënuar një stabilitet demografik, me një dendësi mesatare prej rreth 174.2 banorë për kilometër katror. Kjo dendësi është më e lartë se mesatarja kombëtare, çka reflekton faktin se Drenasi është një komunë me territor kompakt, vendbanime të afërta dhe ekonomi të përqendruar në sektorin primar dhe sekondar.

Ekonomia lokale mbështetet kryesisht në bujqësi, veçanërisht në kultivimin e drithërave, perimeve dhe pemëve frutore, ndërsa zonat kodrinore shfrytëzohen për blegtori dhe pylltari. Një ndikim të madh ekonomik e ka pasur historikisht edhe industria e rëndë, sidomos kompania “NewCo Ferronikeli”, e cila përfaqëson një nga punëdhënësit më të mëdhenj në nivel kombëtar dhe kontribuon ndjeshëm në buxhetin lokal dhe atë të shtetit.

Rrjeti i vendbanimeve të komunës përbëhet nga tridhjetë e tre fshatra, ndër to Gllabar, Arllat, Baicë, Korroticë e Epërme, Korroticë e Ulët, Llapushnik, Krajkovë, Poklek, Sankoc, Shtrubullovo dhe të tjera, të cilat kanë lidhje të mira infrastrukturore me qendrën komunale. Qyteti i Drenasit,

si seli administrative dhe qendër urbane, përmban institucionet kryesore publike, shkollat e mesme, spitalin rajonal, si dhe bizneset e vogla dhe të mesme që gjenerojnë punësim lokal.

Në aspektin e infrastrukturës publike, komuna është e lidhur përmes magjistrales Prishtinë–Pejë, një korridor strategjik që e bën Drenasin lehtësisht të qasshëm nga të gjitha drejtimet e Kosovës. Përveç kësaj, komunës i kalon përmes linja hekurudhore Fushë Kosovë–Pejë, e cila paraqet potencial të rëndësishëm për zhvillimin e transportit të mallrave dhe pasagjerëve.

Në fushën e arsimimit, Drenasi përmban një rrjet të gjerë institucionesh arsimore me shkolla fillore dhe të mesme, që përfshijnë mbi 8,000 nxënës dhe rreth 500 mësimdhënës, sipas të dhënave të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Në sektorin e shëndetësisë, funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe disa nënqendra lokale, të cilat ofrojnë shërbime bazë për banorët e komunës dhe zonave përreth.

Në aspektin demografik e social, struktura e moshës tregon një popullsi relativisht të re: më shumë se 32% e banorëve janë nën moshën 25 vjeç, ndërsa grupmosha mbi 65 vjeç përbën rreth 8% të popullsisë totale. Kjo tregon potencial të konsiderueshëm për zhvillim ekonomik dhe fuqinë punëtore të ardhshme, por njëkohësisht edhe nevojën për investime në arsim profesional, punësim dhe banim për të rinjtë.

Sipas të dhënave të Regjistrimit të vitit 2024, raporti gjinor në komunë është pothuajse i baraspeshuar – 50.2% meshkuj dhe 49.8% femra – ndërsa numri i ekonomive familjare llogaritet rreth 14,500, me një mesatare prej 4.8 anëtarësh për familje.


Nga pikëpamja mjedisore, territori i Drenasit përfshin hapësira të pasura me burime natyrore, si pyjet e Domanekut dhe të Llapushnikut, burime ujore të vogla, lumenj dhe tokë pjellore të përshtatshme për bujqësi intensive. Komuna ka nisur së fundmi projekte për menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, në përputhje me

### **Planin Lokal për Veprim në Mjedis 2025–2029.**

Në aspektin kulturor dhe historik, Drenasi është një ndër komunat me tradita të pasura patriotike dhe shoqërore. Gjatë luftës së fundit, kjo zonë ka qenë një nga qendrat kryesore të rezistencës, dhe sot ruan një numër të madh monumentesh përkujtimore, memoriale dhe komplekse historike që dëshmojnë për kontributin e saj kombëtar.

Në përmbledhje, Komuna e Drenasit paraqet një bashkësi dinamike, me popullsi kryesisht të re, me ekonomi në transformim, me potencial të madh zhvillimor në bujqësi, industri, turizëm rural dhe shërbime. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK, 2024) dhe analiza e

trendëve të fundit demografike tregojnë se Drenasi mbetet një komunë me ritme të qëndrueshme të rritjes, strukturë të balancuar shoqërore dhe potencial të fortë për zhvillim të qëndrueshëm në vitet 2025–2029.



**Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Glllogocit (Drenasit) në Kosovë**

### **3.1 Karakteristikat gjeografike dhe klimatike**

Territori i Komunës së Drenasit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshin një sipërfaqe prej rreth 290 km<sup>2</sup>, që përbëhet kryesisht nga fusha pjellore dhe kodra të ulëta, duke krijuar një peizazh të butë e harmonik mes luginave dhe ngritjeve të lehta. Kjo topografi e bën Drenasin një nga komunat më të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, ndërtimit dhe infrastrukturës, ndërsa nga pikëpamja natyrore, ajo përfaqëson një zonë tranzicioni mes fushës së Dukagjinit dhe asaj të Kosovës qendrore.

Fushat e Drenasit, të shtrira përgjatë rrjedhave të lumenjve Sitnica dhe përroskave anësore, kanë një pjellori të lartë dhe përbëjnë bazën kryesore të zhvillimit të kulturave bujqësore tradicionale si gruri, misri, elbi, dhe kulturat perimore. Kodra të buta si ato të Llapushnikut, Krajkovës, Korroticës dhe Domanekut ofrojnë një larmi gjeomorfologjike që kombinon zonat e kultivimit me ato pyjore e kullosore, duke krijuar kushte ideale për blegtori dhe pylltari.

Në aspektin hidrografik, Drenasi është i pasur me burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Lumi Sitnica, i cili përshkon territorin nga perëndimi në lindje, përbën aksin kryesor ujëmbledhës të komunës dhe luan një rol të rëndësishëm në ujitjen e tokave bujqësore. Në pjesën veriore dhe lindore të komunës ndodhen disa përroska dytësore si përroi e Korroticës, të Gllabarit dhe të Baicës, që kontribuojnë në furnizimin me ujë për bujqësi dhe për nevoja shtëpiake. Në pjesën veriore, territori prek edhe segmentet e sipërme të Lumit të Llapit, duke e bërë këtë zonë pjesë të pellgut ujëmbledhës të Kosovës qendrore.

Përveç lumenjve, në territorin e Drenasit gjenden edhe burime të ujërave nëntokësore, të cilat shfrytëzohen për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm. Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis (2024), më shumë se 61.55 % e ekonomive familjare kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit me tendencë rritje në vitin 2025 edhe për 22 fshatra.

Nga pikëpamja klimatike, Drenasi ka klimë tipike kontinentale, me dimra të ftohtë dhe të lagësht si dhe vera të ngrohta e të thata. Mesatarja vjetore e temperaturës llogaritet rreth 10.5°C, ndërsa reshjet vjetore variojnë nga 650 deri në 750 mm, sipas matjeve të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (2024). Dimrat karakterizohen nga reshje bore që zgjasin zakonisht nga dhjetori deri në shkurt, ndërsa periudha e pranverës është më e përshtatshme për kultivime bujqësore për shkak të lagështisë së moderuar dhe temperaturave të buta.


Klima ndikon drejtpërdrejt në strukturën ekonomike të komunës. Për shkak të dimrave të ftohtë, ka një kërkesë të lartë për energji për ngrohje, veçanërisht në zonat rurale ku ngrohja bëhet

kryesisht me dru zjarri dhe më pak me burime alternative si pelet ose energji elektrike. Në të kundërt, gjatë verës, temperaturat e larta nxisin nevojën për ujitje të vazhdueshme të kulturave bujqësore, sidomos në zonat e fushës ku kultivohet perime intensive dhe misër.

Të dhënat klimatike tregojnë se periudha më e nxehtë është korriku me temperatura që arrijnë mesatarisht deri në 30°C, ndërsa muaji më i ftohtë është janari me temperatura që shpesh zbresin nën -5°C. Këto luhatje të mëdha të temperaturës ndikojnë në dinamikën e prodhimit bujqësor, në ciklet vegetative të bimëve dhe në menaxhimin e burimeve ujore.

Nga aspekti pedologjik, tokat e komunës janë kryesisht bujqësore, me strukturë argjilore dhe përmbajtje të lartë të materieve ushqyese. Sipas të dhënave të vitit 2023 nga Drejtoria Komunale e Bujqësisë, në Drenas janë rreth 12,000 hektarë tokë bujqësore jo të kultivuara, ku dominon prodhimi i drithërave (grurë dhe misër), si dhe kultivimi i frutave sezonalë. Rreth 6,000 hektarë të tjerë shfrytëzohen për kullota, pyje dhe hapësira natyrore.

Përveç karakteristikave natyrore, territori i komunës ka edhe një rëndësi të veçantë strategjike e ekologjike. Ai përbën një zonë tranzicioni mjedisor mes fushës së Kosovës dhe asaj të Dukagjinit, gjë që reflekton në biodiversitet të lartë me lloje të ndryshme bimë e shtazore. Në pjesën jugore gjenden sipërfaqe pyjore të dendura, të cilat përveç funksionit ekonomik, kanë edhe rëndësi ekologjike në stabilizimin e klimës lokale, ruajtjen e erozionit dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Në përfundim, karakteristikat gjeografike dhe klimatike të Drenasit përbëjnë bazën themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, planifikim urban dhe menaxhim të burimeve natyrore. Kombinimi i fushave pjellore, kushteve klimatike të favorshme dhe burimeve ujore të qëndrueshme krijon potencial të madh për bujqësi moderne, për investime në energji të ripërtëritshme dhe për zhvillim të ekoturizmit rural në dekadën e ardhshme.



**Figura 1. Diagrami i klimës i Komunës së Glllogocit (Drenasit) bazuar në të dhënat klimatologjike**

### **3.2 Ekonomia lokale**

Ekonomia e Komunës së Drenasit përfaqëson një ndër modelet më të balancuara në nivelin lokal të Kosovës, duke u mbështetur në tre shtylla kryesore: industrinë, bujqësinë dhe shërbimet. Këta sektorë janë të ndërlidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe së bashku krijojnë një strukturë ekonomike që siguron stabilitet dhe potencial për zhvillim të qëndrueshëm në vitet e ardhshme. Sipas të dhënave të Raportit Ekonomik Komunal 2023, industria kontribuon me rreth 40% të të ardhurave familjare, bujqësia me 25%, ndërsa sektori i shërbimeve dhe tregtisë përbën 35% të ekonomisë lokale.

#### **Industria dhe ndikimi i saj në zhvillim**

Industria mbetet forca lëvizëse e ekonomisë së Drenasit, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në punësim, zhvillim ekonomik dhe të ardhura komunale. Shtylla kryesore industriale është Kombinati Metalurgjik “NewCo Ferronikeli”, i cili përfaqëson një nga investimet më të mëdha të huaja në Kosovë dhe një ndër eksportuesit më të mëdhenj të produkteve minerare.

Feronikeli luan një rol të shumëfishtë: është punëdhënësi më i madh në komunë, ofron mundësi të qëndrueshme punësimi për qindra banorë lokalë dhe gjeneron të ardhura të konsiderueshme për buxhetin komunal përmes taksave dhe tarifave. Megjithatë, ndikimi i kësaj industrie është dyanshëm i ndjeshëm — përveç kontributit ekonomik, ajo është edhe burim i presioneve mjedisore, veçanërisht në ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, si pasojë e emisioneve industriale dhe depozitimit të mbetjeve teknologjike.

Për të balancuar këtë ndikim, komuna, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, ka nisur zbatimin e masave të kontrollit të emisioneve industriale, instalimin e sistemeve filtrues dhe përmirësimin e monitorimit të cilësisë së ajrit, si pjesë e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM 2025–2029). Përveç Ferronikelit, në territorin e Drenasit operojnë edhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) në fushën e ndërtimtarisë, përpunimit të metaleve, përpunimit të drurit, prodhimit të materialeve ndërtimore, si dhe zejtarisë. Zona industriale e Drenasit është në zgjerim, me rreth 70 biznese aktive, që përfshijnë punëtori, fabrika prodhuese, pika tregtare dhe logjistike, të cilat kontribuojnë në diversifikimin e ekonomisë lokale dhe punësimin e të rinjve.

#### **Bujqësia si bazë tradicionale e ekonomisë lokale**

Sektori bujqësor është shtylla tradicionale dhe jetike e jetës rurale në komunë. Mbi 70% e territorit të Drenasit përbëhet nga toka bujqësore dhe kullota, ndërsa 6,000 hektarë përdoren për kultivim aktiv të kulturave bujqësore. Kryesisht kultivohen gruri, misri, elbi, patatja, lakra dhe domatja, të

cilat janë burimi kryesor i të ardhurave për shumë familje rurale. Përveç prodhimeve bimore, blegtoria zë një peshë të rëndësishme, me mbi 3,000 krerë gjedhë dhe 8,000 dele e dhi, sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë (2023).

Krahas këtyre, pemëtaria dhe vreshtaria janë në rritje të ndjeshme, sidomos në zonat kodrinore të Krajkovës, Llapushnikut, Çikatovës dhe Domanekut, ku toka dhe klima favorizojnë kultivimin e mollëve, kumbullave dhe rrushit. Një numër i konsiderueshëm fermerësh po shfrytëzojnë subvencionet qeveritare dhe grantet komunale për modernizimin e fermave dhe instalimin e sistemeve të ujitjes.

Megjithatë, bujqësia përballët me sfida të vazhdueshme që lidhen me fragmentimin e tokës, mungesën e mekanizimit të plotë dhe përdorimin e pesticideve. Përdorimi i pakontrolluar i pesticideve, plehrave kimike dhe herbicideve mund të ndikojë në cilësinë e tokës dhe ujit, prandaj komuna ka vendosur masa për menaxhim të qëndrueshëm të kimikateve, si dhe programe informimi për fermerët lidhur me bujqësinë ekologjike.

Në vitet e fundit, është rritur edhe interesi për bujqësinë organike dhe kultivimet alternative, përfshirë prodhimet mjalti, bimët mjekësore dhe sera moderne. Këto aktivitete janë mbështetur nga projektet e donatorëve ndërkombëtarë dhe programet e zhvillimit rural, të cilat kanë për qëllim rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike në zonat rurale të Drenasit.

### Shërbimet, tregtia dhe ndërtimtaria

Në qendrën urbane të Drenasit, zhvillimi i shërbimeve dhe tregtisë ka marrë hov të madh, veçanërisht pas përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe ndërtimit të objekteve të reja banimi. Sektori terciar përfshin biznese të vogla dhe të mesme, restorante, supermarkete, pika karburanti, shërbime teknike, financiare dhe IT, të cilat krijojnë vende pune dhe kontribuojnë në diversifikimin e ekonomisë.

Sipas të dhënave të Drejtorisë Komunale të Zhvillimit Ekonomik (2023), aktualisht në komunë janë të regjistruara mbi 2,000 biznese aktive, prej të cilave rreth 45% operojnë në tregti dhe shërbime, 30% në industri dhe ndërtim, dhe pjesa tjetër në bujqësi dhe transport.

Ndërtimtaria është ndër sektorët që ka përjetuar rritjen më të madhe në dekadën e fundit, me ndërtimin e objekteve banesore, rrugëve lokale, kanalizimeve dhe projekteve të infrastrukturës publike. Kjo rritje ka gjeneruar punësim sezonal, por gjithashtu ka shtuar nevojën për planifikim urban të kontrolluar dhe menaxhim të qëndrueshëm të tokës ndërtimore.

### Struktura ekonomike dhe perspektivat e zhvillimit

Në bazë të strukturës ekonomike aktuale, ekonomia e Drenasit mund të konsiderohet ekonomi e përzier me potencial të lartë zhvillimor, ku industria dhe bujqësia janë sektorë mbizotërues, ndërsa shërbimet dhe tregtia janë në zgjerim të vazhdueshëm.

Në aspektin e të ardhurave, familjet rurale mbështeten kryesisht në prodhimin bujqësor dhe remitanca, ndërsa ato urbane kanë burime të ardhurash më të larmishme nga bizneset, tregtia dhe puna në sektorin publik.

Komuna ka prioritet të zhvillojë më tej zonën industriale të Drenasit, të krijojë inkubatorë biznesi për ndërmarrësit e rinj dhe të nxisë investime të gjelbra, duke përfshirë energjinë diellore dhe efikasitetin energjetik në ndërtesa.

Në strategjinë e zhvillimit 2025–2029, parashikohet që Drenasi të shndërrohet në një qendër të balancuar industrialo–bujqësore, ku zhvillimi ekonomik shkon paralelisht me mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e cilësisë së jetesës.

### **3.3 Demografia dhe zhvillimi urban**

Popullsia e Komunës së Drenasit përbën një ndër asetet më të rëndësishme të zhvillimit të saj social dhe ekonomik. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK, Regjistrimi i Popullsisë 2024), komuna numëron rreth 48,079 banorë rezidentë, të shpërndarë në qytetin e Drenasit dhe në 36 fshatra përreth.

Mosha mesatare e popullsisë është rreth 35 vjet, çka tregon për një strukturë relativisht të re dhe aktive, me potencial të madh për zhvillim ekonomik, arsimor dhe kulturor. Përbërja gjinore është pothuajse e baraspeshuar — 50.2% meshkuj dhe 49.8% femra — duke reflektuar një ekuilibër natyral që ndikon pozitivisht në tregun e punës dhe në strukturën familjare.

Në aspektin e dinamikës demografike, Drenasi ka një normë vjetore të rritjes së popullsisë prej rreth 1.2%, që është pak më e lartë se mesatarja kombëtare (1.0%), sipas statistikave të ReK 2024. Kjo rritje i atribuohet disa faktorëve: kthimit të diasporës, rritjes së lindshmërisë në zonat rurale, dhe urbanizimit të përshpejtuar që ka ndodhur gjatë dekadës së fundit. Rritja e popullsisë sjell me vete shtim të kërkesës për shërbime komunale, përfshirë arsimin, shëndetësinë, transportin dhe menaxhimin e mbeturinave, si dhe rritje të presionit mbi infrastrukturën ekzistuese.

Struktura e popullsisë dhe shpërndarja hapësinore

Shpërndarja e popullsisë në territor është e pabarabartë. Rreth 26% e banorëve jetojnë në zonat urbane, ndërsa 74% në zonat rurale, ku familjet zakonisht janë më të mëdha dhe të përfshira në bujqësi apo zejtari. Qyteti i Drenasit, si qendër urbane, përmban institucionet kryesore të arsimit,

administratës, shëndetësisë dhe tregtisë, gjë që ka nxitur migrimin e brendshëm nga fshatrat përreth drejt qendrës komunale.

Në dekadën e fundit, janë vërejtur ndryshime të dukshme në strukturën e vendbanimeve — shumë zona të dikurshme rurale, si Komorani, Llapushniku dhe Krajkova, po marrin karakteristika gjysmë urbane për shkak të ndërtimit të shtëpive të reja, zhvillimit të rrugëve dhe afërsisë me qendrën e Drenasit.

Sipas Drejtorisë së Planifikimit Hapësinor dhe Urbanizmit (2023), numri i ekonomive familjare në komunë është rreth 14,500, me një mesatare prej 4.8 anëtarësh për familje. Kjo tregon një strukturë të qëndrueshme familjare tradicionale, por me tendencë drejt reduktimit të përmasës familjare në zonat urbane, ku format bashkëkohore të banimit po zëvendësojnë strukturat e gjera familjare të dikurshme.

### **Zhvillimi urban dhe transformimet hapësinore**

Procesi i urbanizimit në Drenas është intensifikuar ndjeshëm pas vitit 2010, si rezultat i rritjes ekonomike, migrimit të brendshëm dhe investimeve në ndërtim. Qyteti është shtrirë në drejtim të Komoranit dhe Gllabarit, duke përfshirë zona të reja banimi, lagje moderne dhe komplekse afariste.

Në këtë periudhë është vërejtur një transformim i thellë hapësinor, ku tokat bujqësore dhe disa sipërfaqe natyrore janë shndërruar në zona urbane dhe industriale. Ky zhvillim, ndonëse pozitiv për ekonominë, ka sjellë sfida mjedisore dhe planifikuese, sidomos në aspektin e menaxhimit të tokës, furnizimit me ujë, kanalizimit dhe transportit.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK 2020–2027+), rritja e shpejtë e qytetit kërkon masa të rrepta për kontrollin e ndërtimit informal, mbrojtjen e tokës bujqësore me vlerë të lartë dhe zhvillimin e zonave të reja urbane të planifikuara.

### **Presioni mbi infrastrukturën dhe mjedisin**

Rritja demografike dhe zgjerimi urban kanë shkaktuar presion të ndjeshëm mbi infrastrukturën publike. Rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik dhe mbeturinave kanë nevojë për modernizim dhe zgjerim të kapaciteteve, për të përballuar kërkesat e popullsisë në rritje. Në të njëjtën kohë, zgjerimi i zonave industriale, ndërtimi i objekteve të reja banesore dhe rritja e numrit të automjeteve kanë ndikuar në rritjen e ndotjes së ajrit dhe zhurmës urbane, çka përbën një sfidë për Planin Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM 2025–2029).

Komuna është duke zbatuar një qasje të planifikimit të qëndrueshëm urban, duke promovuar ndërtimin vertikal në vend të shtrirjes horizontale, krijimin e hapësirave të gjelbra, zhvillimin e rrjeteve të biçikletave dhe këmbësorëve, si dhe reabilitimin e infrastrukturës ekzistuese. Qëllimi strategjik është që Drenasi të zhvillohet si një qytet modern, funksional dhe ekologjikisht i qëndrueshëm, ku urbanizimi të mos cenojë cilësinë e jetës dhe mjedisin natyror.

### **Tendencat e ardhshme demografike dhe urbane**

Projeksionet e ASK (2024–2029) parashikojnë që popullsia e komunës mund të arrijë deri në 50,000–52,000 banorë në fund të dekadës, nëse ritmet aktuale të rritjes dhe migrimit mbeten të qëndrueshme. Kjo do të kërkojë planifikim më të integruar hapësinor, rishikim të zonave ndërtimore dhe përmirësim të infrastrukturës urbane, për të shmangur mbingarkesën në shërbime publike dhe degradimin mjedisor.

Në përmbledhje, Drenasi po kalon nga një komunë me karakter rural në një qendër urbane me zhvillim të shpejtë, ku dinamika demografike dhe proceset e urbanizimit janë faktorë kyç për politikatat e ardhshme të planifikimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të territorit.

### **3.4 Përdorimi i tokës**

Struktura e përdorimit të tokës në territorin e Komunës së Drenasit përbën një indikator kyç për planifikimin hapësinor, zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e mjedisit. Toka, si resurs natyror i kufizuar, përbën bazën e zhvillimit bujqësor, industrial dhe urban, prandaj menaxhimi i saj i qëndrueshëm është një ndër prioritetet strategjike të komunës për periudhën 2025–2029. Sipas të dhënave të Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit 2023–2029, përdorimi i tokës ndahet si më poshtë:

**Tabela 2. Përdorimi i tokës**

| <b>Lloji i tokës</b>         | <b>Sipërfaqja (ha)</b> | <b>Përqindja e sipërfaqes totale</b> |
|------------------------------|------------------------|--------------------------------------|
| Tokë bujqësore               | 12,000                 | 41%                                  |
| Pyje dhe zona të gjelbëruara | 6,500                  | 22%                                  |
| Zona urbane                  | 7,000                  | 24%                                  |
| Tokë industriale             | 2,500                  | 9%                                   |
| Rrugë dhe infrastrukturë     | 2,000                  | 7%                                   |

### **Analiza e shpërndarjes hapësinore të përdorimit të tokës**

Këto të dhëna tregojnë se tokat bujqësore përbëjnë ende pjesën më të madhe të territorit të komunës, me rreth 41% të sipërfaqes totale, që korrespondon me rreth 12,000 hektarë. Kjo tokë përdoret kryesisht për kulturat tradicionale bujqësore si drithërat, perimet dhe bimët foragjere, ndërsa në disa zona periferike janë të pranishme edhe pemishte dhe vreshta. Megjithatë, presioni urban dhe industrial po ndikon ndjeshëm në reduktimin gradual të kësaj kategorie, sidomos në afërsi të qendrës urbane dhe zonës industriale të Ferronikelit.

Në tri zonat pyjore që janë: Pallaniku , Çyçavica dhe Kosmaqi në të cilat përfshihen fshatrat si Arllat, Llapushnik, Negroc, Krajkovë, Baicë, Çikatovë, Gradicë dhe Vasilevë, Korroticë e Epërme dhe Sankoc. Pyjet e Drenasit përbëhen kryesisht nga lajthia, ahu dhe dushku, dhe përveç rëndësisë ekologjike, ato përfaqësojnë edhe burim ekonomik për komunitetet lokale në formën e drurit të zjarrit dhe produkteve pyjore.

Këto zona janë nën presion të lartë nga prerjet e paligjshme dhe zjarret sezonale, ndaj komuna ka në bashkëpunim me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës do të ndërmarrin masa të veçanta për ruajtjen, rehabilitimin dhe ripyllëzimin e tyre në kuadër të Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM 2025–2029).

### **Zonat urbane dhe procesi i urbanizimit**

Zonat urbane, të cilat mbulojnë rreth 7,000 hektarë ose 24% të territorit komunal, përfshijnë qytetin e Drenasit dhe qendrat dytësore si Komorani, Llapushniku dhe Gllabari. Zgjerimi urban është përsheptuar ndjeshëm në dekadën e fundit për shkak të rritjes së popullsisë, kthimit të diasporës dhe investimeve në ndërtim, gjë që ka sjellë rritje të kërkesës për tokë ndërtimore.

Ky zhvillim, megjithëse pozitiv për ekonominë lokale, ka krijuar presion të dukshëm mbi tokat bujqësore, të cilat po humbin sipërfaqe çdo vit si pasojë e ndërtimit të lagjeve të reja banesore, zonave tregtare dhe infrastrukturës rrugore.

Për të menaxhuar këtë proces, komuna ka hartuar politika të urbanizimit të qëndrueshëm, përfshirë kufizimin e ndërtimit në tokat me cilësi të lartë bujqësore, promovimin e ndërtimit vertikal në qendrën urbane, si dhe ruajtjen e korridoreve ekologjike brenda qytetit.

### **Zonat industriale dhe ekonomike**

Toka industriale, me një sipërfaqe prej rreth 2,500 hektarësh (9%), është e përqendruar kryesisht në afërsi të zonës industriale të Ferronikelit, në perëndim të qytetit.

Kjo zonë përfshin ndërmarrje të mëdha dhe të mesme që merren me përpunimin e metaleve, prodhimin e materialeve ndërtimore, përpunimin e drurit dhe logjistikën.

Në vitet e fundit, komuna ka filluar të zhvillojë një zonë të re industriale komunale, e planifikuar sipas standardeve mjedisore të BE-së, ku do të inkurajohen investimet e pastra dhe bizneset me ndikim të ulët në mjedis.

Megjithatë, zgjerimi i tokave industriale mbetet sfidë, pasi ai shpesh konkurron me hapësirat bujqësore dhe kërkon balancim të kujdesshëm ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së resurseve natyrore.

### **Rrjetet rrugore dhe infrastrukturore**

Rreth 2,000 hektarë, që përfaqësojnë 7% të territorit komunal, janë të zëna nga rrugët, hekurudha dhe infrastruktura komunale. Kjo përfshin magjistralen Prishtinë–Pejë, rrugët rajonale që lidhin Drenasin me Skenderajn dhe Malishevën, si dhe rrjetin e rrugëve lokale që përmirësohet çdo vit.

Infrastruktura publike është shtuar ndjeshëm pas vitit 2018 me ndërtimin e rrugëve të asfaltuara, ndriçimit publik, kanalizimeve dhe ujësjellësve. Megjithatë, ky zhvillim kërkon menaxhim të kujdesshëm të territorit, pasi ndërtimet e reja shpesh cenojnë tokat bujqësore dhe zonat e gjelbëruara.

Komuna është duke punuar në digjitalizimin e kadastrës dhe krijimin e një Sistemi të Informacionit Gjeografik (GIS) për monitorimin e ndryshimeve në përdorimin e tokës, në mënyrë që çdo transformim hapësinor të bazohet në të dhëna të sakta dhe vendimmarrje profesionale.

### **Sfida dhe prioritetet për përdorimin e qëndrueshëm të tokës**


Shpërndarja aktuale e përdorimit të tokës tregon një tendencë drejt reduktimit të hapësirave bujqësore dhe pyjore, si rezultat i zgjerimit urban dhe industrial. Ky proces, nëse nuk menaxhohet me kujdes, mund të shkaktojë humbje të biodiversitetit, erozion të tokës dhe rritje të ndotjes mjedisore.

Për këtë arsye, Plani Zhvillimor Komunal 2023–2029 dhe PLVM 2025–2029 rekomandojnë:

- Ruajtjen e tokave bujqësore me prioritet të lartë, përmes kufizimit të ndërtimit në këto zona;
- Rritjen e sipërfaqeve pyjore dhe gjelbërimin urban për përmirësimin e klimës lokale;
- Zhvillimin e zonave industriale të qëndrueshme, me teknologji të pastra dhe menaxhim të mbetjeve;

- Përdorimin e tokës në bazë të planeve të integruara hapësinore, duke respektuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në përmbledhje, përdorimi i tokës në Drenas pasqyron një proces të vazhdueshëm transformimi, ku zhvillimi urban dhe industrial duhet të balancohet me ruajtjen e kapaciteteve natyrore dhe bujqësore të territorit. Vetëm përmes planifikimit të kujdesshëm, monitorimit të vazhdueshëm dhe respektimit të kritereve mjedisore, komuna do të mund të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm hapësinor në vitet në vijim.



**Harta 2. Harta pedologjike e territorit te Komunës së Glllogocit (Drenasit)**

### 3.5 Burimet natyrore

Komuna e Drenasit është e pasur me burime natyrore të larmishme, të cilat përbëjnë një potencial të madh për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe ekologjik. Këto burime — ujërat, pyjet, ajri dhe toka — kanë rëndësi thelbësore për jetën, prodhimin bujqësor, industrinë dhe mirëqenien e popullsisë.

Megjithatë, ndryshimet klimatike, presioni urban e industrial dhe shfrytëzimi jo i kontrolluar kanë ndikuar në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e këtyre resurseve, duke e bërë menaxhimin e tyre një nga prioritetet kryesore të komunës në kuadër të Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) 2025–2029.

### **Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore**

Rrjeti hidrografik i Drenasit përbëhet nga lumenj, përroska dhe burime nëntokësore, të cilat luajnë rol kyç në furnizimin me ujë të pijshëm, bujqësi dhe ekosisteme.

Lumi Sitnica, që përshkon komunën nga veriu në jug, është burimi më i madh ujëmbledhës dhe përbën aksin kryesor të ujitjes për fushat bujqësore në Arllat, Baicë dhe Korroticë. Përveç tij, përroskat lokale si Përroi i Gllabarit, Baicës, Domanekut dhe Llapushnikut ndihmojnë në pasurimin e sistemit ujqor dhe krijojnë mikrohabitate me vlera ekologjike të rëndësishme.

Në territorin e komunës gjenden gjithashtu burime të ujërave nëntokësore, të cilat furnizojnë sistemin e ujësjellësit komunal dhe disa puse të fshatrave. Analizat e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (2023) tregojnë se cilësia e ujit në burime është përgjithësisht e mirë, por në disa zona afër zonës industriale janë vërejtur rritje të përqendrimit të metaleve të rënda dhe nitrates, të lidhura me aktivitetet industriale dhe përdorimin e plehrave kimike.

Ndotja e ujërave sipërfaqësore vjen kryesisht nga emisionet industriale të Ferronikelit, mbetjet urbane dhe kanalizimet e pa trajtuara. Aktualisht, vetëm një pjesë e qytetit të Drenasit është e lidhur me sistemin e kanalizimit që derdhet në impiantin e trajtimit, ndërsa zonat rurale ende përdorin gropa septike, të cilat përbëjnë burim potencial kontaminimi për ujërat nëntokësore. Për ta adresuar këtë çështje, PLVM 2025–2029 parashikon ndërtimin e impianteve të reja për trajtimin e ujërave të zeza, rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit dhe instalimin e sistemeve të monitorimit të cilësisë së ujit në pikat më të ndjeshme mjedisore.

### **Pyjet dhe biodiversiteti**

Pyjet e Komunës së Drenasit mbulojnë rreth 6,500 hektarë, që përbën rreth 22% të sipërfaqes totale të territorit. Ato janë të përqendruara kryesisht në tri zonat pyjore që janë: Pallaniku, Çyçavica dhe Kosmaqi në të cilat përfshihen fshatrat si Arllat, Llapushnik, Krajkovë, Baicë, Çikatovë, Gradicë dhe Vasilevë, duke krijuar një brez të gjelbër me rëndësi të madhe ekologjike dhe klimatike.

Këto pyje përbëhen kryesisht nga ah, dushk, lajthi dhe shkozë, me përzierje të specieve bimore autoktone që përbëjnë një biodiversitet të pasur. Pyjet jo vetëm që shërbejnë si burim druri për

ngrohje, por gjithashtu kontribuojnë në rregullimin e klimës lokale, ruajtjen e ujërave nëntokësore dhe parandalimin e erozionit.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës (2023), presioni mbi pyjet është rritur dukshëm gjatë viteve të fundit për shkak të prerjeve ilegale, zjarreve sezonale dhe zgjerimit të zonave ndërtimore. Vetëm në vitin 2023 janë raportuar mbi 80 raste të prerjeve të paligjshme, të cilat kanë ndikuar në fragmentimin e habitatit natyror dhe në humbjen e disa llojeve të rralla të florës.

### **Cilësia e ajrit dhe ndikimet mjedisore**

**Ajri** në Komunën e Drenasit është një ndër elementet më të ndjeshme mjedisore, i ndikuar drejtpërdrejt nga aktivitetet industriale, trafiku rrugor dhe ngrohja me lëndë fosile. Sipas Raportit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK, 2023), nivelet e grimcave PM10 dhe dyoksidit të squfurit (SO<sub>2</sub>) në disa zona urbane të Drenasit tejkalojnë kufijtë e lejuar të Direktivës Evropiane 2008/50/EC për cilësinë e ajrit.

Pikat më të ndjeshme janë afër zonës industriale të Ferronikelit dhe përgjatë magjstrales Prishtinë–Pejë, ku lëvizja e automjeteve të vjetra dhe djegia e karburanteve me cilësi të ulët janë burime kryesore ndotjeje.

Në Komunën e Drenasit operojnë mbi pesë gurthyes aktivë, të cilët përbëjnë një nga burimet më të theksuara të ndotjes së ajrit dhe të degradimit të mjedisit natyror. Aktivitetet e tyre, që përfshijnë thyerjen, bluarjen dhe përpunimin e gurëve, gjenerojnë sasi të mëdha pluhuri dhe grimcash të imta që përhapen në atmosferë dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit. Këto grimca, përveç ndikimit negativ në mjedis, paraqesin edhe rrezik për shëndetin e banorëve përreth, duke shkaktuar probleme respiratore dhe ulje të cilësisë së jetës.

Për më tepër, veprimtaritë e gurthyesve shpesh ndikojnë edhe në degradimin e tokës, shkatërrimin e vegjetacionit përreth dhe ndryshimin e peizazhit natyror. Zhurma e lartë nga pajisjet dhe makineritë, si dhe lëvizjet e vazhdueshme të automjeteve transportuese, shtojnë ndikimin negativ në mjedis dhe komunitet.

Për të reduktuar dhe parandaluar këto ndikime, është e domosdoshme që operatorët e gurthyesve të zbatojnë masa efektive mbrojtëse. Këto përfshijnë vendosjen e filtrave në objektet e thyerjes dhe bluarjes për të ndaluar përhapjen e pluhurit, instalimin e sistemeve të spërkatjes për lagjen e sipërfaqeve gjatë procesit të punës, si dhe ndërtimin e barrierave mbrojtëse ndaj erozionit dhe zhurmës. Po ashtu, pas përfundimit të periudhës së shfrytëzimit, duhet të sigurohet rikthimi i

pronës në gjendjen e saj fillestare përmes rikultivimit të tokës, nivelimit të terrenit dhe zbatimit të projekteve të ripyllëzimit. Këto masa do të kontribuonin në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës lokale.

Në periudhat e dimrit, ndotja shtohet ndjeshëm për shkak të përdorimit të drurit dhe qymyrit për ngrohje, veçanërisht në zonat me dendësi të lartë banimi. Kjo ndikon jo vetëm në cilësinë e ajrit, por edhe në shëndetin publik, duke rritur rastet e sëmundjeve respiratore dhe alergjive. Përmirësimi i cilësisë së ajrit është një ndër prioritetet e PLVM 2025–2029, i cili parashikon:

- Instalimin e stacioneve automatike për matjen e ajrit në qendrën e qytetit dhe pranë zonës industriale;
- Subvencionimin e burimeve alternative të energjisë (si peleti dhe panelet diellore);
- Zëvendësimin gradual të automjeteve publike me mjete elektrike ose hibride;
- Mbjelljen e brezave pyjorë përgjatë rrugëve për uljen e ndotjes me pluhur.

Në vitin 2024, AMMK raportoi se për herë të parë në Drenas u krye monitorimi tremujor i përqendrimeve të PM<sub>2.5</sub> dhe NO<sub>2</sub>, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi të integruar të kontrollit të ajrit në nivel lokal.


Vlerësim i përgjithshëm dhe sfida për të ardhmen

Burimet natyrore të Drenasit përbëjnë një potencial të madh për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, por ato janë njëkohësisht të brishta dhe të ndjeshme ndaj presioneve njerëzore. Rritja e popullsisë, zgjerimi i zonave urbane dhe industriale, përdorimi i lëndëve fosile dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve e ujërave kërkojnë një qasje integruese dhe të bazuar në të dhëna shkencore për menaxhimin e tyre.

Komuna ka për synim që përmes Planit të Veprimit Mjedisor, Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe bashkëpunimit me institucionet qendrore të sigurojë:

- Ruajtjen e resurseve ujore dhe pyjore;
- Përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- Promovimin e energjisë së pastër dhe teknologjive të gjelbra;
- Krijimin e një baze të dhënash mjedisore digjitale për planifikim afatgjatë.

Në përmbljedhje, ujërat, pyjet dhe ajri përbëjnë shtyllat themelore të ekosistemit të Drenasit. Vetëm përmes menaxhimit të përgjegjshëm, monitorimit të vazhdueshëm dhe ndërgjegjësimi të qytetarëve, komuna do të mund të sigurojë ruajtjen e këtyre pasurive natyrore për gjeneratat e ardhshme.



**Harta 3. Harta gjeologjike e territorit të Komunës së Glllogocit**

### **3.6 Infrastrukturë dhe shërbime**

Zhvillimi ekonomik, rritja e popullsisë dhe urbanizimi i shpejtë kanë sjellë rritje të konsiderueshme të kërkesës për infrastrukturë moderne dhe shërbime publike të qëndrueshme në Komunën e Drenasit.

Infrastruktura përbën shtyllën themelore të zhvillimit të qëndrueshëm, pasi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës, konkurrueshmërinë ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në vijim paraqitet një pasqyrë e hollësishme e gjendjes aktuale të sektorëve kryesorë infrastrukturorë: transportit, ujësjellësit dhe kanalizimit, energjisë dhe shërbimeve publike.

#### **Transporti dhe lidhjet rrugore**

Rrjeti rrugor i Komunës së Drenasit përbën një ndër komponentët më të zhvilluar të infrastrukturës fizike, duke e lidhur territorin me qendrat kryesore ekonomike të Kosovës.

Qyteti i Drenasit ndodhet në një pozitë strategjike përgjatë magjistrales Prishtinë–Pejë, e cila është një nga arteriet më të rëndësishme kombëtare. Kjo rrugë përshkon komunën në drejtim lindje–perëndim, duke e lidhur Drenasin me Prishtinën (rreth 30 km larg) dhe me Pejën në perëndim. Përveç magjistrales, komuna ka një rrjet të gjerë rrugësh lokale dhe rajonale, që lidhin fshatrat me qendrën komunale dhe me zonat industriale. Gjatësia e përgjithshme e rrugëve komunale llogaritet mbi 512.5 kilometra, prej të cilave rreth 70% janë të asfaltuara, ndërsa pjesa tjetër është me zhavorr ose në proces rehabilitimi.

Në aspektin e transportit publik, aktualisht funksionojnë disa linja autobusi dhe furgonësh që lidhin Drenasin me Prishtinën, Skenderajn, Malishevën dhe Fushë Kosovën. Sidoqoftë, mungesa e një stacioni qendror modern të autobusëve, infrastruktura e kufizuar për biçikleta dhe mungesa e korsive për këmbësorë janë çështje që kërkojnë zgjidhje afatmesme.

Në zonën industriale të Ferronikelit, qarkullimi i automjeteve të rënda është i lartë, gjë që shkakton ndotje të ajrit, zhurmë dhe dëmtim të infrastrukturës rrugore. Për këtë arsye, komuna ka parashikuar në planin e saj zhvillimor ndërtimin e një rruge anashkaluese (by-pass) për të devijuar trafikun industrial jashtë qendrës urbane.

Në planin afatgjatë, synohet krijimi i një sistemi të integruar transporti, që përfshin:

- Rregullimin e rrjeteve rrugore dytësore;
- Ndërtimin e parkingjeve publike dhe shtigjeve ekologjike për biçikleta;
- Promovimin e transportit publik të gjelbër me mjete elektrike ose hibride;

- Përdorimin e teknologjive të menaxhimit inteligjent të trafikut për uljen e ndotjes dhe bllokimeve rrugore.

### **Ujësjiellësi dhe kanalizimi**

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm në Komunën e Drenasit mbulon një pjesë të konsiderueshme të zonës urbane dhe disa qendra të mëdha rurale, si Komorani, Llapushniku, Gllabari dhe Korrotica e Epërme.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike (2023), rreth 85% e popullsisë urbane ka qasje në ujë të pijshëm të rregullt, ndërsa në zonat rurale përqindja është rreth 65%, me diferenca të mëdha midis fshatrave.

Sfidat kryesore lidhen me mungesën e investimeve në rrjetin e vjetër, humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe mosmbylljes së ciklit të furnizimit, si dhe mungesën e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza. Aktualisht, një pjesë e ujërave të ndotura shkarkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në përraska, duke ndikuar në ndotjen e mjedisit dhe burimeve ujore. Në kuadër të Planit Lokal për Veprim në Mjedis (2025–2029) dhe bashkëpunimit me KRU “Prishtina”, komuna ka paraparë projekte për:

- Zgjerimin e rrjetit të ujësjiellësit në zonat rurale të pa mbuluara;
- Ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në qytetin e Drenasit;
- Rehabilitimin e puseve të vjetra dhe instalimin e matësve digjitalë të konsumit të ujit;
- Ndërgjegjësimin e qytetarëve për shfrytëzimin racional të ujit dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

### **Energjia dhe ngrohja**

Sistemi energjetik i komunës mbështetet pothuajse tërësisht në rrjetin kombëtar të KEDS-it, me shpërndarje stabile të energjisë elektrike në të gjitha zonat urbane dhe pjesërisht rurale. Megjithatë, burimi kryesor i ngrohjes për familjet e Drenasit mbetet druri dhe lëndët fosile (qymyr, pelet), të cilat përdoren sidomos gjatë muajve të dimrit. Kjo formë ngrohjeje tradicionale është ekonomike për shumë familje, por shkakton emisione të larta të CO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> dhe grimcave PM10, duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe shëndetin publik.

Sipas Raportit të Agjencisë së Mjedisit (2023), gjatë periudhës dimërore nivelet e ndotjes nga ngrohja shtëpiake arrijnë deri në dyfishin e kufijve të lejuar, veçanërisht në lagjet urbane ku mungon qarkullimi i ajrit.

Për të reduktuar këto ndikime, Komuna e Drenasit po promovon përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, përfshirë panelet diellore për ngrohje uji dhe izolimin termik të ndërtesave publike.

Në strategjinë e zhvillimit 2025–2029, parashikohet implementimi i programeve të efikasitetit energjetik në institucione publike, shkolla dhe objekte shëndetësore, si dhe nxitja e partneriteteve publike–private për ndërtimin e kapaciteteve të vogla të energjisë diellore.

### **Shërbimet publike dhe infrastruktura komunale**

Përveç transportit, ujit dhe energjisë, shërbimet komunale përfshijnë edhe menaxhimin e mbeturinave, ndriçimin publik, hapësirat e gjelbra dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Komuna bashkëpunon me kompaninë KRM”PASTRIMI” për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, por mbulimi i plotë nuk është arritur ende. Rreth 82.5 % e ekonomive familjare janë të përfshira në sistemin formal të mbledhjes së mbeturinave, ndërsa pjesa tjetër i depoziton ato në mënyrë të pakontrolluar, duke krijuar deponi ilegale.

Ky fenomen paraqet një sfidë serioze mjedisore, ndaj janë planifikuar veprime konkrete për eliminimin e deponive ekzistuese, vendosjen e kontejnerëve të riciklimit dhe ndarjen e mbeturinave në burim (organike, plastike, metalike e qelqi).

Ndriçimi publik është zgjeruar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, me instalimin e sistemeve LED në qytetin e Drenasit dhe në disa fshatra. Kjo ka kontribuar në kursim energjie dhe në siguri më të madhe për qytetarët gjatë natës.

Gjithashtu, janë realizuar projekte të reja për hapësira të gjelbra, parqe, kënde lojërash dhe shtigje për këmbësorë, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës urbane dhe mirëqenien sociale.

### **Sfidat infrastrukturore dhe perspektivat e zhvillimit**

Megjithëse infrastruktura e Drenasit ka njohur përmirësime të konsiderueshme, komuna përballet ende me një sërë sfidash strukturore dhe mjedisore. Ndër më të rëndësishmet janë:

- Ndotja e ajrit dhe ujërave nga industria dhe trafiku;
- Presioni mbi tokat bujqësore për shkak të zgjerimit urban dhe industrial;


- Mungesa e mbulimit të plotë me ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale;
- Menaxhimi i pamjaftueshëm i mbeturinave dhe riciklimit;
- Ndikimi i burimeve tradicionale të ngrohjes në cilësinë e ajrit.

Për të përballuar këto sfida, Komuna e Drenasit synon që në periudhën 2025–2029 të orientojë politikat e saj drejt infrastrukturës së qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, duke investuar në:


- Energjinë e pastër dhe sistemet diellore;
- Zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Ndërtimin e infrastrukturës për transport publik të gjelbër;
- Rritjen e gjelbërimit urban dhe menaxhimin ekologjik të mbeturinave.

Në përfundim, infrastruktura dhe shërbimet e Drenasit përbëjnë bazën për zhvillimin e ardhshëm të komunës.

Zbatimi i planeve të reja investive, modernizimi i rrjeteve ekzistuese dhe integrimi i teknologjive të gjelbra do ta pozicionojnë Drenasin si një komunë moderne, të qëndrueshme dhe me infrastrukturë të avancuar, në harmoni me mjedisin dhe nevojat e qytetarëve të saj.



**Harta 4. Harta e rrugëve në komunën e Glogocit (Drenasit)**



Harta 5. Harta e ujësjiellësit kanalizimit dhe ujitjes

#### 4. GJENDJA E MJEDISIT

Mjedisi në Komunën e Drenasit përbën një ndër fushat më të ndjeshme dhe më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Pozita gjeografike në pjesën qendrore të Kosovës, prania e industrisë së rëndë si “NewCo Ferronikeli”, rritja e shpejtë urbane dhe zgjerimi i aktiviteteve bujqësore e ndërtimore kanë sjellë ndryshime të konsiderueshme në cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit lokal.

Komuna përballlet me sfida të shumta mjedisore, të cilat kërkojnë qasje të integruar, planifikim afatgjatë dhe bashkëpunim ndërinstitucional për të mbrojtur burimet natyrore dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve.

Presionet kryesore mjedisore

Presionet që ndikojnë në gjendjen e mjedisit të Drenasit janë të shumëfishta dhe të ndërlidhura. Sipas Raportit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit (2023) dhe Analizës së Ndikimeve Industriale Lokale (2024), burimet kryesore të ndotjes dhe degradimit mjedisor janë:

- Aktivitetet industriale, veçanërisht nga kompleksi metalurgjik “NewCo Ferronikeli”, i cili lëshon në atmosferë sasi të konsiderueshme të grimcave PM10, oksideve të squfurit (SO<sub>2</sub>), oksideve të azotit (NO<sub>x</sub>) dhe metaleve të rënda;
- Urbanizimi i shpejtë dhe ndërtimet e pakontrolluara, që kanë reduktuar hapësirat e gjelbra dhe kanë shkaktuar humbje të tokave bujqësore;
- Trafiku në rritje, që ka ndikuar në rritjen e ndotjes së ajrit dhe zhurmës urbane;
- Menaxhimi i pamjaftueshëm i mbeturinave, me prezencë të deponive ilegale në disa zona periferike;
- Prerjet ilegale të pyjeve dhe shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i burimeve ujore, që ndikojnë në biodiversitet dhe erozionin e tokës.

Këta faktorë, të kombinuar me mungesën e sistemeve të plota të monitorimit mjedisor, krijojnë një situatë komplekse që kërkon vlerësim dhe ndërhyrje sistematike.

Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit në Drenas është një ndër sfidat më të mëdha mjedisore. Matjet e kryera nga Agjencia e Mjedisit (2023) dhe të dhënat e stacioneve lokale të monitorimit tregojnë se në disa periudha të vitit, sidomos gjatë dimrit, koncentrimet e grimcave PM10 dhe PM2.5 tejkalojnë kufijtë e lejuar nga standardet e BE-së dhe OBSH-së.

Burimet kryesore të ndotjes janë emisionet industriale, trafiku, si dhe ngrohja me dru dhe lëndë fosile në amvisëri.

Në zonën urbane të Drenasit, përqendrimet mesatare të PM10 arrijnë deri në 80–100 µg/m<sup>3</sup> në ditët me ngrohje intensive, duke tejkaluar disa herë kufirin ditor prej 50 µg/m<sup>3</sup>.

Përveç grimcave, është vërejtur edhe prezencë e lartë e dioksidit të squfurit (SO<sub>2</sub>), i cili ndikon në shëndetin e qytetarëve dhe acidifikimin e tokës.

Komuna ka filluar zbatimin e programeve për uljen e ndotjes së ajrit, siç janë:

- Nxitja e përdorimit të energjisë së pastër (panelet diellore dhe ngrohja elektrike);
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbra dhe mbjellja e brezave pyjorë mbrojtës;
- Kontrolli më rigoroz i emisioneve industriale dhe inspektimet mjedisore periodike;
- Edukimi i publikut për efektet e ngrohjes tradicionale dhe mënyrat alternative të kursimit energjetik.

### **Burimet ujore dhe cilësia e ujit**

Komuna e Drenasit përshkohet nga disa lumenj dhe përroska, ndër të cilët më i rëndësishmi është Lumi Drenica, degë e lumit Sitnicë. Ky sistem ujërash përbën një burim jetik për bujqësinë, industrinë dhe jetën e përditshme të qytetarëve.

Megjithatë, cilësia e ujit është përballur me sfida të mëdha për shkak të shkarkimeve industriale, ujërave të zeza urbane pa trajtim dhe mbeturinave të shpërndara përgjatë brigjeve. Sipas monitorimeve të AMMK-së (2023), në disa segmente të lumit janë regjistruar vlera të larta të përbërjeve kimike, përfshirë nitrate, fosfate dhe metale të rënda, që tejkalojnë standardet kombëtare për ujëra sipërfaqësore.

Në kuadër të Planit Lokal për Veprim në Mjedis, komuna ka paraparë:

- Ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Rehabilitimin e shtretërve të lumenjve dhe pastrimin e deponive ilegale përgjatë brigjeve;
- Kontrollin e shkarkimeve industriale nëpërmjet licencimit dhe monitorimit periodik;
- Promovimin e bujqësisë së qëndrueshme, me reduktim të pesticideve dhe plehrave kimike.

### **Toka dhe përdorimi i saj**

Tokat bujqësore përbëjnë një aset të çmuar për zhvillimin e komunës, por janë gjithnjë e më shumë nën presion nga ndërtimet urbane dhe industriale.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal 2023–2029, rreth 41% e territorit (12,000 ha) janë toka bujqësore, ndërsa 9% janë zona industriale në rritje.

Urbanizimi i pakontrolluar ka çuar në fragmentim të sipërfaqeve të kultivuara, humbje të tokave me vlerë të lartë prodhuese dhe rritje të erozionit në disa zona kodrinore. Në disa lokalitete, është vërejtur edhe kontaminim i lehtë i tokës nga mbeturinat industriale dhe depozitimet e metaleve të rënda, kryesisht përreth zonës së Ferronikelit dhe Komoranit.

Komuna ka në plan të zbatojë masa të mbrojtjes së tokave bujqësore, përfshirë:

- Rishikimin e kufijve të ndërtimit në zonat me potencial të lartë bujqësor;
- Rehabilitimin e tokave të degraduara dhe shndërrimin e tyre në hapësira gjelbërimi;
- Nxitjen e praktikave të bujqësisë organike dhe përdorimin e plehrave natyrale.

### **Biodiversiteti dhe pyjet**

Pyjet e Drenasit mbulojnë rreth 6,500 hektarë, që përbëjnë 22% të territorit. Ato janë kryesisht pyje dushku, ahu dhe lisa të përzier, me një biodiversitet të pasur floristik dhe faunistik. Megjithatë, prerjet ilegale, zjarret periodike dhe ndërtimet pa plan kanë reduktuar ndjeshëm sipërfaqet pyjore dhe kanë ndikuar në fragmentimin e habitateve natyrore. Në raportin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë (2023), vlerësohet se rreth 3–5% e sipërfaqes pyjore humbet çdo vit, për shkak të ndërhyrjeve të paautorizuara dhe mungesës së masave rigjeneruese.

Gjendja e mjedisit në Komunën e Drenasit paraqitet si komplekse dhe sfiduese, por njëkohësisht me potencial të lartë për përmirësim.

Ndikimet negative nga industria, trafiku dhe ndërtimet urbane janë të pranishme, por mund të reduktohen përmes planifikimit të qëndrueshëm, modernizimit të infrastrukturës dhe përfshirjes aktive të qytetarëve në mbrojtjen e mjedisit.

Zbatimi i Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2025–2029, i mbështetur në të dhëna statistikore dhe instrumente ligjore të Kosovës, përbën një hap të rëndësishëm për arritjen e objektivit strategjik:

“Një Drenas më i pastër, më i gjelbër dhe më i shëndetshëm, ku zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit ecin në harmoni.”

## **4.1 Ajri**

### **4.1.1 Burimet e ndotjes së ajrit**

Ndotja e ajrit në Komunën e Gllogocit është ndër sfidat më të mëdha mjedisore, e ndikuar kryesisht nga aktivitetet industriale, transporti, ngrohja lokale dhe faktorë të tjerë antropogjenë. Këto burime

kontribuojnë në përqendrimet të larta të pluhurit të imët (PM10 dhe PM2.5), oksideve të azotit (NO<sub>x</sub>), dioksidit të squfurit (SO<sub>2</sub>), monoksidit të karbonit (CO) dhe metaleve të rënda, të cilat ndikojnë negativisht në shëndetin e njerëzve dhe në ekosistemet përreth.

### **Industria**

Burimi kryesor i ndotjes së ajrit në territorin e Gllogocit është Kombinati Metalurgjik “NewCo Ferronikeli”, që përbëhet nga shkretorja dhe dy miniera sipërfaqësore në Çikatovë dhe Gllavicë. Procesi i prodhimit të hekur-nikelit (Fe-Ni) përfshin shkrirjen e xeheve që përmbajnë squfur, si dhe djegien e lëndëve fosile, duke çliruar në atmosferë gaze si SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO<sub>2</sub> dhe pluhur të imët. Gjatë viteve të fundit, në stacionet e monitorimit janë regjistruar tejkalime të ndotësve metalikë, veçanërisht për nikelin (Ni), që është identifikuar në nivele mbi kufirin e lejuar prej 20 µg/m<sup>3</sup>. Këto tejkalime janë vërejtur në lokacione si Çikatova e Vjetër, Çikatova e Re, Gllobar dhe lagjja e Ferronikelit, sidomos gjatë muajve tetor–dhjetor, kur kushtet meteorologjike favorizojnë përqendrimin e ndotësve.

Monitorimi i emisioneve nga “Feronikeli” kryhet përmes kompanisë “Tehnolab” nga Shkupi, dhe raportet zyrtare të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) kanë evidentuar periudha me tejkalim të parametrave të lejuar për SO<sub>2</sub> dhe pluhurat e imët. Përveç Ferronikelit, në territorin e komunës veprojnë edhe punishte metalike, gurëthyes, fabrika betoni dhe impiante të ndërtimit, që përbëjnë burime të rëndësishme të pluhurit dhe gazrave ndotës. Këto aktivitete ndikojnë drejtpërdrejt në ajrin përreth, veçanërisht në zonat e banuara afër Çikatovës dhe Korroticës, ku banorët shpesh raportojnë turbullim të ajrit dhe depozitim të pluhurit në sipërfaqe të hapura.

### **Transporti**

Transporti rrugor është një tjetër kontribuues i rëndësishëm në ndotjen e ajrit. Në komunë qarkullojnë rreth 9,843 automjete, pjesa më e madhe e të cilave janë me motorë me djegie të brendshme dhe me teknologji të vjetër, duke shkarkuar CO<sub>2</sub>, CO, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub> dhe grimca PM10. Lëvizja e automjeteve të rënda industriale përgjatë akseve si rruga nacionale Prishtinë–Pejë dhe ajo regjionale Mitrovicë–Lipjan, si dhe transporti i mineraleve nga kompleksi industrial në Çikatovë, rrit ndjeshëm përqendrimet e ndotësve dhe krijon ndotje të dukshme me pluhur. Për më tepër, mungesa e infrastrukturës përcjellëse, si shtigje për biçikleta dhe këmbësorë, rrit varësinë nga automjetet motorike. Kjo gjendje, e kombinuar me mungesën e kontrollit periodik të

gazrave të shkarkimit dhe përdorimin e karburanteve me cilësi të ulët, e bën transportin një burim të qëndrueshëm të ndotjes në ajër.

Në shumë pjesë urbane, veçanërisht në qendër të qytetit dhe rreth rrethit të Komoranit, ndotja nga trafiku arrin nivele të larta gjatë orëve të pikut. Për shkak të kushteve të terrenit dhe mungesës së gjelbërimit mbrojtës, ndotësit shpërndahen ngadalë, duke ndikuar në shëndetin e qytetarëve dhe në përkeqësimin e cilësisë së jetës urbane.

### **Ngrohja lokale**

Një ndër burimet kryesore sezonale të ndotjes së ajrit në Glllogoc është ngrohja lokale gjatë dimrit. Sipas të dhënave të PLVM, thëngjilli dhe druri dominojnë si burime energjetike në krahasim me peletin dhe naftën, si në objektet publike, ashtu edhe në ekonomitë familjare. Përdorimi i sobave të vjetra dhe kaldajave pa sisteme filtrimi çliron në atmosferë sasi të mëdha pluhuri, CO, NOx dhe komponime organike të paqëndrueshme. Këta ndotës ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit, sidomos në periudhat me inversone termike, kur shtresat e ajrit të ftohtë e mbajnë ndotjen e bllokuar pranë tokës.

Në këto kushte, përqendrimet e PM10 dhe PM2.5 rriten ndjeshëm, shpesh duke tejkaluar normat e lejuara ligjore, siç dëshmohet nga të dhënat e stacionit të monitorimit në qytet. Në vitin 2018, u regjistruan 82 ditë me tejkalime të parametrave të PM10, kryesisht gjatë dimrit. Ky problem është i pranishëm sidomos në zonat e dendura të banimit ku përdoren dru dhe qymyr për ngrohje, ndërsa mungojnë sistemet e qarkullimit të ajrit.

Një zgjidhje e qëndrueshme, e përmendur në PLVM, është instalimi i sistemit të ngrohjes qendrore me bashkëprodhim të energjisë (ko-gjenerim) duke shfrytëzuar nxehtësinë që lirohet nga kullat e ftohjes së Ferronikelit. Kjo masë do të reduktonte ndjeshëm përdorimin e lëndëve djegëse fosile dhe emetimet e ndotësve lokalë.

### **Ndotja nga bizneset e vogla dhe aktivitetet urbane**

Përveç industrisë dhe transportit, një ndikim të rëndësishëm kanë edhe objektet komerciale të vogla, si furrat e bukës, restorantet, kafenetë, hotelet dhe dyqanet, që përdorin lëndë djegëse për ngrohje ose përgatitje ushqimore. Në komunë janë regjistruar rreth 280 objekte të tilla, të cilat lëshojnë në atmosferë grimca PM10, PM2.5, SO<sub>2</sub> dhe CO.

Ky lloj ndotjeje është i shpërndarë në mënyrë të barabartë nëpër lagjet urbane, por ndikon ndjeshëm në cilësinë e ajrit për shkak të mungesës së oxhaqeve të larta dhe ventilimit efikas. Kjo bën që ndotja të grumbullohet në shtresat e ulëta të atmosferës, sidomos në periudhën e dimrit.

#### 4.1.2 Të dhëna statistikore

Sipas Raportit të Agjencisë së Mjedisit 2023

Tabela 3. Cilësia e ajrit në Drenas

| Indikatori                                   | Vlera mesatare vjetore | Kufiri i lejuar (Kosovë) | Statusi       |
|----------------------------------------------|------------------------|--------------------------|---------------|
| PM10 ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )            | 45                     | 40                       | Tejkalim      |
| SO <sub>2</sub> ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ ) | 55                     | 50                       | Tejkalim      |
| NO <sub>2</sub> ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ ) | 35                     | 40                       | Brenda normës |
| CO <sub>2</sub> (ppm)                        | 420                    | —                        | normal        |

Vlerat tregojnë se cilësia e ajrit në disa zona urbane tejkalon kufijtë e lejuar për PM10 dhe SO<sub>2</sub>, sidomos gjatë dimrit dhe periudhave me aktivitet të lartë industrial.




Figura 3. Cilësia e ajrit në disa zona urbane

## 4.2 Ujërat

### 4.2.1 Burimet e ujit

- **Ujërat sipërfaqësore:** Lumenjtë Sitnica dhe përroskat lokale përdoren për ujësjellës, bujqësi dhe peshkim.
- **Ujërat nëntokësore:** Përdoren për ujitjen e tokave dhe furnizimin e komuniteteve rurale.

#### 4.2.2 Ndotja e ujërave

Ndotja e ujërave përbën një ndër sfidat më të rëndësishme mjedisore në territorin e Komunës së Drenasit, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Burimet kryesore të ndotjes janë shkarkimet industriale, ujërat e zeza të patrajuara dhe rrjedhjet difuze nga aktivitetet bujqësore. Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura nga zonat urbane dhe industriale, si dhe deponimi i pa kontrolluar i mbetjeve, kanë ndikuar në përkeqësimin e parametrave fizikë, kimikë dhe biologjikë të ujërave.

- **Shkarkimet industriale dhe ujërat e zeza të pa trajtuara** janë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e ujit. Fabrika “NewCo Ferronikeli” dhe disa subjekte të tjera ekonomike lëshojnë ujëra teknologjike me përmbajtje të lartë ndotësish organikë dhe inorganikë, të cilët përfundojnë në përroska dhe në lumin Sitnicë. Gjithashtu, mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në shumicën e zonave banesore shkakton derdhje të drejtpërdrejtë të ujërave të zeza në kanalet ujëmbledhëse, duke rritur ngarkesën organike dhe mikrobiologjike në mjedis.
- Sipas **Raportit të Agjencisë së Mjedisit të Kosovës (2023)**, në pikat monitoruese përgjatë lumit Sitnica janë evidentuar disa tejkalime të parametrave bazë të cilësisë së ujit, si më poshtë:

**Tabela 4. Cilësia e ujit të lumit Sitnicë**

| Parametër                               | Sitnica (µg/L) | Kufiri sipas standardeve | Statusi       |
|-----------------------------------------|----------------|--------------------------|---------------|
| NH <sub>4</sub> <sup>+</sup> (Amoniumi) | 2.5            | 1.5                      | Tejkalim      |
| NO <sub>3</sub> <sup>-</sup> (Nitrati)  | 40             | 50                       | Brenda normës |
| BOD (mg/L)                              | 12             | 10                       | Tejkalim      |
| Kripërat totale (mg/L)                  | 350            | 500                      | Brenda normës |




Figura 4. Cilësia e ujit të lumit Sitnicë

Të dhënat tregojnë se përqendrimet e amoniakut (NH<sub>4</sub><sup>+</sup>) dhe ngarkesa organike e matur me BOD tejkalojnë kufijtë e lejuar sipas standardeve kombëtare të cilësisë së ujërave. Këto tejkalime janë tregues të pranishmërisë së ndotjes organike, që buron kryesisht nga ujërat e zeza të patrajtuara, rrjedhjet nga stallat, mbetjet bujqësore, si dhe nga infiltrimet e depozitave industriale.

Prania e amoniakut dhe azotit total në nivele të larta tregon për procesin e dekompozimit të materieve organike dhe për mungesë oksigjeni të tretur në ujë, duke shkaktuar kushte anaerobe që dëmtojnë ekosistemin ujor. Ngarkesa e lartë BOD (Biochemical Oxygen Demand) reflekton shkallën e lartë të konsumit të oksigjenit nga mikroorganizmat për dekompozimin e substancave organike, çka ndikon negativisht në florën dhe faunën ujore.

Nga ana tjetër, përqendrimet e nitratit (NO<sub>3</sub><sup>-</sup>) dhe të kripërave totale janë brenda kufijve të lejuar, megjithëse tendencat e rritjes në periudha të caktuara lidhen me përdorimin intensiv të plehrave kimikë dhe pesticideve në bujqësi. Kjo tregon se ndotja bujqësore është e pranishme, por aktualisht në nivel të moderuar.

Në mungesë të një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale, ndotja pritet të mbetet problem serioz edhe në vitet në vijim, nëse nuk ndërmerren masa parandaluese dhe rehabilituese. Rekomandohet që Komuna të intensifikojë bashkëpunimin me Agjencinë e Ujërave dhe institucionet përgjegjëse për monitorim, për të siguruar kontroll më efektiv të shkarkimeve

industriale, përmirësim të infrastrukturës së kanalizimit dhe ngritje të vetëdijes publike për ruajtjen e cilësisë së ujit.

Në përfundim, rezultatet tregojnë qartë se ndotja e ujërave në territorin e Komunës së Drenasit është e lidhur ngushtë me aktivitetet njerëzore – veçanërisht me industrinë dhe bujqësinë – dhe se nevojitet një qasje e integruar për mbrojtjen e burimeve ujore, që përfshin monitorim të rregullt, investime në trajtimin e ujërave të zeza dhe zbatim të masave të qëndrueshme mjedisore.

#### **4.3 Toka dhe përdorimi i tokës**

Tokat e Komunës së Drenasit janë një burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe për mirëqenien e komunitetit lokal. Megjithatë, presioni i vazhdueshëm nga aktivitetet industriale, urbanizimi dhe bujqësia intensive kanë ndikuar në degradimin e cilësisë së tyre, duke sjellë humbje të pjellorisë, ndotje dhe ndryshime në strukturën natyrore të peizazhit.

##### **Degradimi i tokës**

Degradimi i tokës në Drenas është një proces i vazhdueshëm që ndodh për shkak të ndikimeve të kombinuara nga industria e rëndë, përdorimi i kimikateve bujqësore, erozioni dhe deponimi i pakontrolluar i mbetjeve. Fabrika “NewCo Ferronikeli” (deponite e saja) lirojnë grimca pluhuri metalik, që përmbajnë nikel, krom dhe hekur, të cilat depozitohen në sipërfaqen e tokës dhe ndikojnë në përmbajtjen kimike të saj. Në Komunën e Drenasit operojnë mbi pesë gurthyes aktivë, të cilët përbëjnë një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit dhe degradimit të mjedisit. Aktivitetet e tyre, që përfshijnë thyerjen dhe bluarjen e gurëve, gjenerojnë sasi të mëdha pluhuri dhe grimcash të imta që ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e banorëve përreth. Përveç ndotjes së ajrit, këto veprimtari shkaktojnë degradim të tokës, dëmtim të vegjetacionit dhe ndryshim të peizazhit natyror, ndërsa zhurma dhe trafiku i rëndë rrisin shqetësimet mjedisore dhe sociale.

Për të reduktuar ndikimet negative, kërkohet zbatimi i masave parandaluese si vendosja e filtrave në objektet e përpunimit, instalimi i sistemeve të spërkatjes për uljen e pluhurit dhe ndërtimi i barrierave mbrojtëse ndaj erozionit dhe zhurmës. Pas përfundimit të shfrytëzimit, duhet të bëhet rikultivimi dhe ripyllëzimi i zonave të prekura, me qëllim rikthimin e pronës në gjendjen fillestare dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit lokal.

Në zonat përreth qendrës industriale dhe përgjatë rrjedhës së Sitnicës janë evidentuar vlera të ngritura të metaleve të rënda dhe humbje të pjellorisë. Përdorimi i vazhdueshëm i plehrave kimikë dhe pesticideve, pa respektuar dozimet dhe rekomandimet agronomike, ka ndikuar në uljen e përmbajtjes së materies organike dhe në prishjen e strukturës së tokës.

**Tabela 5. Treguesit kryesorë të cilësisë së tokës në Komunën e Drenasit (burim: Raportet komunale dhe AMMK 2023)**

| Parametër / Tregues            | Njësia matëse | Vlera mesatare e matur | Kufiri sipas standardeve kombëtare | Vlerësimi i gjendjes    |
|--------------------------------|---------------|------------------------|------------------------------------|-------------------------|
| Materia organike               | %             | 1.4                    | $\geq 2.0$                         | E ulët                  |
| pH (reaksioni i tokës)         | -             | 6.3                    | 6.0 – 7.5                          | Brenda normës           |
| Nikel (Ni)                     | mg/kg         | 140                    | 75                                 | Tejkalim i lartë        |
| Krom (Cr)                      | mg/kg         | 110                    | 100                                | Tejkalim i lehtë        |
| Plumb (Pb)                     | mg/kg         | 45                     | 50                                 | Brenda normës           |
| Kadmium (Cd)                   | mg/kg         | 1.1                    | 1.0                                | Tejkalim minimal        |
| Pjelloria relative             | %             | 72                     | $\geq 85$                          | E ulët                  |
| Tokat e degraduara (sipërfaqe) | ha            | 285                    | -                                  | Zonë me ndikim të lartë |

Këta tregues tregojnë se tokat bujqësore dhe periferike të komunës janë të ekspozuara ndaj ndotjes metalike dhe humbjes së pjellorisë, veçanërisht në afërsi të zonave industriale. Tejkalimet e vlerave për nikelin dhe kadmiumin janë një sinjal serioz për ndotje afatgjatë, që mund të ndikojë edhe në zinxhirin ushqimor.

### Deponitë ilegale

Një problem i shprehur në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Drenasit janë deponitë ilegale të mbeturinave. Sipas raportit të mjedisit 2023, janë evidentuar rreth 15–18 pika deponish ilegale, që përfshijnë kryesisht mbetje shtëpiake, inerte ndërtimi dhe materiale plastike.

Këto deponi ndodhen kryesisht në periferi të vendbanimeve, përgjatë rrugëve lokale dhe në afërsi të rrjedhave ujore, duke krijuar ndotje të tokës, ujërave nëntokësore dhe një ndikim negativ vizual në peizazh. Në disa raste, është konstatuar përzierje e mbetjeve të rrezikshme industriale me ato komunale, duke shtuar rrezikun për ndotje kimike të shtresave të tokës.

Përmes aksioneve të përbashkëta me qytetarët dhe organizatat lokale, komuna ka arritur të eliminojë një pjesë të deponive, por, ndonëse sistemi i menaxhimit të mbeturinave ekziston dhe funksionon në mënyrë të përhershme, mungesa e vetëdijesimit qytetar mbetet një problem thelbësor. Për pasojë, krijohen shpesh deponi ilegale në zona të ndryshme, sidomos nga operatorët ekonomikë të ndërtimit, të cilët zhvillojnë aktivitetet e tyre jashtë zonës së Drenasit, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndotjen dhe degradimin e mjedisit.

**Tabela 6. Deponitë ilegale të identifikuara në territorin e Komunës së Drenasit (2023)**

| <b>Nr.</b> | <b>Lokacioni</b>          | <b>Tipi i mbetjeve</b>          | <b>Sipërfaqja (m<sup>2</sup>)</b> | <b>Statusi aktual</b> |
|------------|---------------------------|---------------------------------|-----------------------------------|-----------------------|
| 1          | Gllobar                   | Inerte industriale dhe metalike | 2,500                             | Aktive                |
| 2          | Fushë Glllogovc           | Mbetje komunale të përziera     | 1,200                             | Pjesërisht pastruar   |
| 3          | Komoran – rruga nacionale | Plastikë dhe goma               | 800                               | Aktive                |
| 4          | Tërstenik                 | Inerte ndërtimi                 | 1,000                             | Pastruar              |
| 5          | Çikatovë e Vjetër         | Mbetje bujqësore dhe urbane     | 600                               | Aktive                |
| 6          | Poklek                    | Mbetje komunale                 | 700                               | Pastruar              |
| 7          | Baicë                     | Përzierje mbetjesh ndërtimore   | 1,100                             | Aktive                |

Totali i sipërfaqes së ndotur nga deponitë ilegale llogaritet të jetë **rreth 9,000–10,000 m<sup>2</sup>**, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e tokës dhe në ambientin përreth.

#### **Përdorimi i tokës**

Struktura e përdorimit të tokës në komunë paraqitet e larmishme, por e karakterizuar nga presion i lartë urban dhe industrial.

**Tabela 7. Struktura e përdorimit të tokës në Komunën e Drenasit (2023)**

| Kategoria e tokës              | Sipërfaqja (ha) | Përqindja (%) | Vlerësim i ndikimit                    |
|--------------------------------|-----------------|---------------|----------------------------------------|
| Tokë bujqësore                 | 12,500          | 41%           | Presion mesatar nga ndotja             |
| Pyje dhe zona të gjelbra       | 6,700           | 22%           | Presion i ulët, por rrezik nga prerjet |
| Zonë urbane dhe industriale    | 12,000          | 39%           | Presion i lartë ekologjik              |
| Tokë e degraduar / e braktisur | 700             | 2%            | Zonë me ndikim të lartë                |

Përhapja e ndërtimit dhe zhvillimi i industrisë kanë shkaktuar tkurrje të zonave bujqësore dhe pyjore, duke çuar në fragmentim të habitateve natyrore dhe humbje të biodiversitetit.

**Masa dhe rekomandime për përmirësim**

1. Monitorim i vazhdueshëm i cilësisë së tokës përmes analizave vjetore të parametrave kimikë dhe biologjikë.
2. Rehabilitim i zonave të degraduara përmes mbulimit me shtresë pjellore dhe pyllëzimit.
3. Reduktim i përdorimit të plehrave kimikë dhe orientim drejt bujqësisë organike.
4. Eliminim i deponive ilegale dhe krijim i një sistemi elektronik për raportimin e tyre.
5. Kontroll më i rreptë i ndotjes industriale përmes inspektimeve periodike dhe kërkesave për trajtimin e mbetjeve teknologjike.
6. **Zbatim i planifikimit hapësinor ekologjik**, që ruan ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Gjendja aktuale e tokës në Komunën e Drenasit paraqet rrezik për produktivitetin bujqësor, shëndetin publik dhe ekosistemet natyrore. Megjithatë janë ndërmarrë hapa pozitivë në menaxhimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e disa zonave, është e domosdoshme të zbatohet një qasje e integruar për menaxhimin e tokës, që kombinon masa parandaluese, teknika të qëndrueshme bujqësore dhe mbrojtje ligjore të mjedisit. Vetëm përmes monitorimit sistematik dhe planifikimit të kujdesshëm mund të ruhet funksioni ekologjik dhe ekonomik i tokës për brezat e ardhshëm.

#### 4.4 Biodiversiteti dhe pyjet

- Pyjet mbulojnë rreth 22% të territorit, me specie të ndryshme druri dhe flora/faunë të pasura.
- Presioni kryesor: prerjet ilegale, ndërtimet e paligjshme dhe ndotja.
- Sipas Strategjisë Kombëtare për Biodiversitetin 2021–2025, Drenasi është zonë me biodiversitet të konsiderueshëm, veçanërisht për zogjtë dhe specie të rralla bimore.

#### 4.5 Menaxhimi i mbeturinave

- Në komunë prodhohen rreth 7,209 tonë mbeturina vjetore, sipas raporteve komunale 2023.
- Vetëm **82.5%** mbulohet nga shërbimet komunale të mbeturinave; pjesa tjetër depozitohet ilegalisht.
- Plan Komunal i menaxhimit të mbeturinave parashikon ndërtimin e një qendre riciklimi dhe mbylljen e deponive ilegale brenda 3–5 viteve.

#### 4.6 Zhurma dhe ndotjet e tjera

- Nivelet e zhurmës tejkalojnë kufijtë e rekomanduar në zonat urbane pranë rrugëve kryesore dhe zonave industriale.
- Aktiviteti industrial dhe trafiku kontribuojnë në ndotje akustike që ndikon në shëndetin e banorëve dhe cilësinë e jetës.

#### 4.7 Ndryshimet klimatike dhe sfidat e ardhshme

- Temperaturat mesatare vjetore janë rreth **11.5°C**, me rritje të lehtë gjatë dekadës së fundit (+0.3°C/10 vite).
- Shtimi i periudhave të thatësisë dhe përmbytjeve kërkon planifikim të kujdesshëm të infrastrukturës dhe bujqësisë.
- PLVM duhet të adresojë edhe masat për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike.

Analiza e gjendjes së mjedisit tregon se Komuna e Drenasit ka sfida të shumta në të gjitha sektorët: ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin dhe menaxhimin e mbeturinave.

